



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Nr. 55 prot.

Tiranë, më 27.01.2025

**URDHËR I BRENDSHËM**

Nr. 12, datë 27.01.2025

Bazuar në asistencën teknike që Projekti “Bashki të Forta” (BtF), një projekt i Swiss Development and Cooperation (SDC) i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (HIS), i ofron Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, shpallet pozicioni:

- Ekspert Lokal

**Titulli i punës:**

Ekspert Lokal pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në vijim referuar si “AMVV”

**Përshkrimi i Projektit:**

Bashki të Forta (BTF) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (HIS). Projekti është në fazën e dytë. Qëllimi kryesor i saj është që qytetarët në Shqipëri të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe të përballueshme të dakordësuara për një sistem të qëndrueshëm.

Faza e dytë e projektit të Bashki të Forta do të vazhdojë të forcojë këshillat bashkiakë dhe të përmirësojë menaxhimin e mbetjeve dhe shërbimet parashkollore (kopshtet). BtF do të mbështesë palët e interesuara të sistemit për të rënë dakord mbi standardet minimale të përballueshme për dhënien e shërbimeve dhe qeverisjen e mirë; Të intensifikojë ndërhyrjet e saj në fushën e performancës duke ndërtuar një sistem mbarëkombëtar të menaxhimit të performancës, të cilin do ta plotësojë një skemë grantesh bazuar në performancë. Është një element thelbësor i qasjes, që ndërhyrjet do të bashkëprojektohen me organizatat me një rol sistematik në pushtetin vendor shqiptar, në mënyrë që ato të marrin pronësinë e plotë të ndërhyrjeve. Aktorët sistematikë përkatës (veçanërisht

AMVV) do të mbështeten për të zhvilluar analiza teknike që ndikojnë në politika dhe për të dhënë njohuri për bashkitë. Mbështetja e BTF-së do të shtrihet në të 61 bashkitë e Shqipërisë, duke i dhënë përparësi një numri bashkish model në veçanti komponent i projektit.

## 1. Organizimi

Njësia organizative	Programi Bashki të forta, një projekt i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (HSI).
Vendi	Tiranë -Shqipëri, Zyra e AMVV-së. Aktivitetet do të zbatohen në Shqipëri (kryesisht në Tiranë, me udhëtime të shkurtra në terren nëse është e nevojshme). Eksperti do të punësohet nga BTF/SDC në Shqipëri dhe do të punojë në zyrat e AMVV, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të AMVV-së.
Kohëzgjatja	Eksperti do të punësojë në kuadrin e BTF/SDC për këtë detyrë nga shkurt 2025 – dhjetor 2025. Një zgjatje e mëtejshme është e mundur duke rishikuar detyrat. (ndahet midis AMVV dhe BtF/SDC). Puna do të fillojë në muajin shkurt pas përzgjedhjes së ekspertit.
Dokumentat kryesore të referencës (korniza për veprën):	Dokumentat kryesore të referencës në bazë të së cilave ai/ajo organizon punën janë: ProDoc/YPO, MOU me AMVV dhe kuadri ligjor shqipëtar.
Paga dhe marrëdhënia e punës (pozicioni me kohë të pjesshme 10 ditë në muaj):	Marrëdhënia e punës bazohet në Kodin e Punës të Shqipërisë (dhe Helvetas NPR). Në të gjitha rastet nuk është më shumë se 230,000 lekë neto në muaj. Konsulenti është përgjegjës për të paguar taksat dhe shërbimet sociale. BtF do ta rimbursojë këtë mbi pagesën mujore neto. Konsulenti duhet të jetë i regjistruar në sistemin tatimor

## 2. Raportimi

Raportimi	Raportimi javor për Drejtorin e Përgjithshëm të AMVV-së. Raportimi mujor në BtF (duke përfshirë fletët kohore) bazuar në planet tremujore të punës dhe treguesit e performancës rënë dakord. Raporti mujor dërgohet së bashku me faturën e pagesës. Raporti mujor të dërgohet së bashku me faturën e pagës
-----------	---

### 3. Qëllimi i Përgjithshëm

Qëllimi kryesor është mbështetja e Ministrit përgjegjës për çështjet vendore, AMVV-së (Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore) dhe bashkive në përmirësimin e performancës së tyre dhe cilësisë së shërbimeve publike të ofruara në nivel vendor, përmes nismave ligjore që fuqizojnë qeverisjen vendore, konsolidimit të sistemit të matjes dhe vlerësimit të performancës, si dhe lehtësimit të procesit të Integritimit Evropian duke harmonizuar standardet dhe praktikatat me kërkesat e Bashkimit Evropian.

### 4. Detyrat kryesore

Eksperti lokal do të ofrojë asistencë teknike në këto fusha kyçe:

- Të ofrojë mbështetje për Ministrin përgjegjës për çështjet vendore dhe AMVV në trajtimin e çështjeve ligjore që ndikojnë në përmirësimin e performancës dhe standardeve të shërbimeve të ofruara nga bashkitë, duke përfshirë përgatitjen e materialeve sipas rastit.
- Të ofrojë asistencë teknike në fusha kyçe si pjesë e Grupit Teknik të Punës për matjen e performancës së bashkive, duke propozuar një model të qëndrueshëm, përfshirë rekomandimet për nismat që kërkojnë rregullime ligjore;
- Të ofrojë asistencë ligjore për përgatitjen e akteve të tjera ligjore (projektligje, VKM, strategji, udhëzime, etj.) të paraqitura nga ministritë e linjës për opinionin e Ministrit të Shtetit ose të Këshillit Konsultativ, përfshirë përgatitjen e materialeve përkatëse, kur kërkohet;
- Të analizojë dhe vlerësojë ndërfaqen e ndërhyrjes së BtF-së me aspekte të integritimit evropian në kuadrin e strategjisë kombëtare të integritimit evropian dhe kuadrit tjetër rregullator që zbaton për integrimin evropian, duke përfshirë: (i) asistencë ligjore për përgatitjen e akteve ligjore (ligje, VKM, strategji, udhëzime) të lidhura me çështjet e integritimit me qëllim përmirësimin e performancës së bashkive, (ii) analizën e kuadrit përkatës të integritimit evropian për fushën e përgjegjësisë së Ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe AMVV-së, përfshirë përmbushjen e detyrimeve si negociatori përgjegjës për Kapitullin 22; (iii) analizën e ndërlidhjes dhe kontributit të skemës në menaxhimin e performancës (dhe treguesit e performancës), me kuadrin e proceseve të integritimit evropian; (iv) analiza dhe kontributi i Grantit të Bazuar në Performancë me kuadrin e proceseve të integritimit evropian (v) përshtatjen e kuadrit planifikues të

AMVV-së për sa i përket financimit të GBP-së, me potencial për financim të Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë.

- Të nxisë hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor të përshtatshëm për: (i) decentralizimin e funksioneve nëpërmjet angazhimit dhe kontributit në analizën e funksioneve dhe shërbimeve të përzgjedhura të bashkive, në koordinim me BTF dhe bazuar në kontributet e BTF-së në sektorin e arsimit parashkollor dhe atë të menaxhimit të mbetjeve, (ii) miratimin/përmirësimin e skemave organizative në nivel vendor për përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet angazhimit dhe kontributit në analizën e ofrimit të shërbimeve, duke vlerësuar kuadrin e zhvillimeve të BtF në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

## 5. Produktet e pritshme

Eksperti lokal pritët të dorëzojë këto rezultate kryesore:

- **Përgatitja e akteve ligjore** (Ligjet, VKM), raportet, analizat në kuadër të AMVV-së në procesin e Integritimit Evropian (Kapitulli 22) ose që lidhen me aktet e tjera të paraqitura nga ministrat e linjës për opinionin e Ministrit të përgjegjës për çështjet vendore ose për Këshillin Konsultativ, duke siguruar që këto akte ndihmojnë në rritjen e performancës dhe efektivitetit të bashkive.
- **Përgatitja e inpueteve teknike** lidhur me (i) kontributin e ndërhyrjes së BTF-së në procesin e integritimit evropian; (iii) përgatitjen e kuadrit ligjor për përmirësimin e mjedisit për organizimin e dorëzimit në nivel vendor (aktet ligjore, amendamentet, prezantimet e gjetjeve etj.).
- **Raportet e analizës:** Të përgatisë analiza ligjore në kuadër të grupit të punës si dhe draft-amendamenteve në përputhje me marrëveshjet e grupit të punës, si dhe materiale të tjera ose prezantime (PPT), që mund të kërkohen nga grupi i punës ose BtF.

## 6. Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara për pozicionin

**Kualifikimet dhe përvoja:**

- Master Shkencor në Drejtësi.
- Njohuri mbi strukturën e qeverisjes vendore dhe proceset administrative në Shqipëri.
- Njohuri mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht lidhur me decentralizimin, menaxhimin e shërbimeve publike dhe integritimin evropian
- Njohuri mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për vlerësimin e performancës së bashkive.

### **Përvojë profesionale specifike:**

Përvojë pune me sektorët publikë dhe OJQ-të (jo më pak se 10 vjet).

- Përvojë në hartimin e dokumenteve me karakter teknik dhe rregullator (ligje, VKM, udhëzime etj).
- Përvojë në projekte të lidhura me proceset e integritimit evropian dhe harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me standardet e BE-së.
- Eksperiencë në organizimin dhe përgatitjen e prezantimeve teknike dhe raportimeve për palë të interesuara.

### **Aftësitë e përgjithshme:**

- Njohuri shumë të mira të anglishtes dhe gjuhës shqipe në të folur dhe të shkruar;
- Aftësi të mira komunikimi, sociale/ekipore dhe raportuese;
- Kontroll i mirë i mjeteve dhe programeve Microsoft Office.

Afati për dorëzimin e dokumentave është data 3 shkurt 2025, ora 12:00 pranë protokollit të AMVV-së.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Ermal ELEZI**

